



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr.20/2023

Nr. Protokoli: 30/2023

Për:	SEFERI-CO SH.P.K., Gjinoc-Suharekë, 23000, Suharekë
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Fatos Kuqi Shef i zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	19.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, **Kerkeses për Rishqyrtim** të derguar në Platforme Elektronike të datës: **12.04.2023** të parashtruar nga "SEFERI-CO SH.P.K., Gjinoc-Suharekë, 23000, Suharekë" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve lokale Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh**. me Nr. të Prokurimi: **624-23-1008-5-2-1 & 624-23-04-521** nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **12.04.2023** të parashtruar nga operatori ekonomik: **SEFERI-CO SH.P.K., Gjinoc-Suharekë, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve lokale Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh**. me Nr. të Prokurimi: **624-23-1008-5-2-1 & 624-23-04-521** nxjerr këtë:
- II. Me gjithat Autoriteti Kontraktues ju informon që aktiviteti i Prokurimit "Ndërtimi dhe Sanimi i Rrugëve lokale Sopijë- Vraniq dhe Reqan Bukosh" në bazë të disa kërkesave për Rishqyrtim do të kthehet në **Rivlersim**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **12.04.2023** ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik " **SEFERI-CO SH.P.K.**, Gjinoc-Suharekë, 23000, Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi dhe sanimi i rrugëve lokale Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh**

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë,

Interpretimi i KRPP-ës ka të bëjë me normën e gabuar të TVSH psh: në vend të 8% e vendos 18% . Përderisa ju si Operator Ekonomik nuk keni gabuar në vlerën e normës së TVSH-ës prej 18% por e keni llogaritur dy herë normën e TVSH-ës për këtë arsye interpretimi i KRPP-ës nuk ka të bëjë me rastin tuaj.

Në këtë aktivitet të Prokurimit kanë marr pjesë tetë (8) Operator Ekonomik dhe të gjithë ata (për veç jush) formularin e përshkrimit të çmimeve e kane plotësuar si duhet.

Në këtë kontest, nëse ju si Operator Ekonomik keni pasur hamendje apo keqkuptime për rreshtat apo kolonat të përmendur në Kërkesën tuaj për Rishqyrtim, ju si Operator Ekonomik është dashur të kërkonit sqarime shtesë në bazë të nenit **53 të LPP-ës gjatë fazës së tenderimit**.

Me gjithat Autoriteti Kontraktues ju informon që aktiviteti i Prokurimit " Ndërtimi dhe Sanimi i Rrugëve lokale Sopijë- Vraniq dhe Reqan Bukosh" në bazë të disa kërkesave për Rishqyrtim do të kthehet në **Rivlersim**.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shefi zyres së Prokurimit

Fatos Kuqi

